



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.968/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha, kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Franciska Zhitija, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit G...shpk nga Kaçaniku, të cilin e përfaqëson Armend Deskaj avokat nga Prishtina kundër të paditurës Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) në Prishtinë, me bazë juridike, kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e propozuesit-paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2780/2019 të datës 05.03.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 06.10.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit G...shpk nga Kaçaniku e ushtruar me datë 29.03.2021, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2780/2019 të datës 05.03.2021, Vërtetohet.

A R S Y E T I M

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e paditësit-propozuesit G...shpk nga Kaçaniku, me të cilin ka kërkuar nga Gjykata, caktimin e masës së sigurisë që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurës, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale me nr.protokoli ... dt.22.10.2019.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi - propozuesi, përmes të autorizuarit të tij, me të cilën e ka kundërshtuar ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, aplikimit të gabuar të ligjit material dhe konstatimit të gabuar të gjendjes së fakteve, me propozim që Gjykata e Apelit, të ndryshoj aktvendimin e atakuar lidhur me propozimin e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit KPMM m nr.protok.... dt.22.10.2019, i ndalohej të paditurit-kundër propozuesit KPMM që të ndërmarr çfarëdo veprimi në lidhje me tarifimin në lidhje me mirëmbajtjen mujore dhe vjetore në KPMM për shfrytëzimin e licencës nga ana e paditësit. Aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore si dhe LKA-së nga që arsyetimi është në kundërshtim me provat e deponuara në shkresat e lëndës, sepse gjykata fare nuk e ka

shqyrtuar dhe arsyetuar rrethanat se KPMM në mënyrë të kundërligjshme nuk i ndalon fakturimin e pagesave mujore dhe vjetore, paditësi është duke pësuar dëm të pariparueshëm me vet faktin e bllokimit të shumës 25,000.00€ por edhe fakturimin e pagesave mujore e vjetore.

E paditura-kundërpropozuesja në përgjigjen në ankesë deklaron se ankesën e paditësit e konsideron si të paligjshme për shkak se ankesa nuk përmban kurrfarë arsytimi ligjor. Pretendimet e paditësit janë të pabaza sepse paditësi nuk ka se çka të dëmtohet pasi që nuk i është aprovuar propozimi për masë të përkohshme sepse i dëmtuari në rastin konkret është KPMM pasi që resurset minerare pavarësisht nga prejardhja e tyre forma dhe gjendja fizike që gjenden në brendësin e tokës apo në sipërfaqe dhe brenda territorit të Republikës së Kosovës, janë pronë e Republikës së Kosovës, paditësi me asnjë fakt nuk e ka bërë të besueshëm se ankesa dhe kërkesa për caktimin e masës së përkohshme janë të besueshme, andaj i propozojmë Gjykatës së Apelit ta refuzoj ankesën e paditësit dhe ta vërtetoj Aktvendimin A.nr.2780/2019 dt.05.03.2021 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e kundërshtuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, gjen se gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të propozimit të paditësit për shtyrje e ekzekutimit të vendimit nr.... dt.22.10.2021 të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale në Prishtinë, ka gjetur se propozimi i tillë është i pabazuar, ngase paditësi-propozuesi nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë të vetme pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të paditurit, të njëjtit do ti sillte dëm i cili vështirë do të riparohej dhe se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do ti sillte ndonjë dëm të pariparueshëm palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, kusht ky ligjor i cili duhet të provohet nga paditësi, për të shtyrë pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kontestuar. Andaj, gjykata gjatë vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, iu ka referuar dispozitave ligjore të nenit 22 par.2 dhe 6 të Ligjit për Konfliktin Administrativ.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshme qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret nuk janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës

kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me ankesën e ushtruar kërkon që të ndryshohet Aktvendimi shkallës së parë, lidhur me propozimin për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të paditurit KPMM-së, dhe ti ndalohet të paditurit që të ndërmarr çfarëdo veprimi në lidhje me tarifimin në mirëmbajtjen mujore dhe vjetore në KPMM, për shfrytëzimin e licencës.

Duke i marrë parasysh këto pretendime ankimore të propozuesit- paditësit, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë jo të vërtetuara, të pamjaftueshme dhe jo bindëse për tu aprovuar ankesa dhe për tu lejuar shtyrja e ekzekutimit të vendimit të atakuar deri në vendosjen sipas padisë së paditësit. Ngase edhe vlerësimi i Kolegjit është se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së. Sepse, kërkesa tërësisht është e mbështetur në faktet që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, për të cilat gjykata do të vendosë në mënyrë meritore pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të kërkesëpadisë për anulimin e vendimit të kontestuar, por të cilat tani nuk janë me ndikim për vlerësimin e besueshmërisë së kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve Kolegji, gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të KPMM-së, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit, me rastin e refuzimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast paditësi në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme pretendimet e tij, se janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, e me të cilin do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit duke ju referuar dispozitave ligjore, të nenit 22 par.2 të LKA-së. Prandaj, pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së aktvendimit nuk ka konstatuar gjendjen faktike, janë të pabazuara dhe të paqëndrueshme. Sepse, sipas vlerësimit të Kolegjit të kësaj Gjykate, Aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj, ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa Aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.968/2022 datë 06.10.2022

Kryetari i Kolegjit-gjyqtari  
Krenar Berisha